



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 3766/ Prot

Lezhë 20.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. — Datë 20/07/2026

**“PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “DUKAGJINI NR.03160041” ME
EMRIN “PALOKA NR. 03160041” NË FSHATIN SHENKOLL NJËSIA
ADMINISTRATIVE SHENKOLL”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, me kërkesë të komunitetit të zonës, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë vendosi:

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e emërimit të rrugës “**Dukagjini nr. 03160041**” me emrin “**Paloka nr. 03160041**” në fshatin Shenkoll, Njësia Administrative Shenkoll.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE
MJEDISIT

Nr. 3766/2 Prot,

Lezhë, me 20.07.2026

**RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN
“PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “DUKAGJINI NR.03160041” ME
EMRIN “PALOKA NR. 03160041” NË FSHATIN SHENKOLL NJËSIA
ADMINISTRATIVE SHENKOLL”**

Ky projekt-vendim paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Lezhë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe kërkesës me nr 4679 Prot. datë 15.04.2026 nga banorët e fshatit Shenkoll, Njësia Administrative Shenkoll të cilët e frekuentojnë këtë rrugë.

Nëpërmjet kësaj kërke, banorët e fshatit Shenkoll, Njësia Administrative Shenkoll kanë propozuar që segmenti rrugor **Dukagjini nr.03160041** të ndryshohet me emrin **“Paloka nr.03160041”**, kjo kërkesë mbështetet në faktin se rruga ndodhet në një zonë të re urbane, e cila nuk ka një traditë të hershme ose lidhje historike me emërtimin aktual “Dukagjini”. Po ashtu, banorët që jetojnë në këtë rrugë nuk kanë lidhje familjare, historike apo shoqërore me këtë emërtim, ndaj ai nuk përfaqëson identitetin e komunitetit.

Nga ana tjetër, prej shumë vitesh në këtë rrugë banojnë familje që i përkasin fisit Paloka, të cilat përbëjnë komunitetin kryesor të kësaj zone. Për këtë arsye, emërtimi “Paloka” pasqyron më mirë përbërjen aktuale të banorëve dhe identitetin e tyre.

Duke qenë se bëhet fjalë për një zonë të re, ku emërtimet duhet të reflektojnë sa më mirë realitetin dhe identitetin e komunitetit lokal, vlerësojmë se emërtimi “Paloka” do të ishte më përfaqësues, më i përshtatshëm dhe më në përputhje me karakterin e kësaj rruge.

KRYETARI
Pjerin NDREU

